



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Komisioni Qendror i Zgjedhjeve*  
*Centralna Izborna Komisija*  
*Central Election Commission*



**PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

**Nr. 03**

**Datë: 11. 01. 2021. Ora: 13:30**

**Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.**

**Valdete Daka, kryetare e KQZ - së.**

**Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Alim Rama, Eshref Vishi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Artan Asllani, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši.**

**SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.**

**ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.**

**Përkthyes: Argjina Misini**

**Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.**

---

**RENDI I DITËS**

**1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:**

**2. Aktivitetet e ZRPPC-së**

- Shqyrtimi dhe aprovimi i kufizimit të shpenzimeve të fushatës për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës

**3. Raport i Këshillave të KQZ-së:**

**-Këshilli për Operacione Zgjedhore**

-Shqyrtimi dhe miratimi i tekstit për periudhën e aplikimit për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës në ueb faqen e KQZ-së

**-Këshilli për Çështje Ligjore**

- Shqyrtimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të kuvendit komunal në Podujevë

**4.Të ndryshme.**

---

## **1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:**

**Valdete Daka:** Përshëndetje për të gjithë. Mirë se keni ardhur në mbledhjen e tretë të KQZ-s. A kemi diçka në lidhje me rendin e ditës? Po urdhëro Arianit.

**Arianit Elshani:** Faleminderit kryetare. Propozojmë që në kuadër të raportimeve të këshillit për çështje ligjore të shtohen dy vendime. Verifikimi i aplikacioneve për periudhën e aplikimit për regjistrimin e votuesve nga jashtë dhe një pikë tjetër e radhës për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për miratimin e formularëve për aplikim, votim jashtë Kosovës për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kuvendin e Kosovës. Dy vendime të cilat realisht janë rekomanduar edhe nga këshilli për operacione zgjedhore dhe më pas janë trajtuar në këshillin për çështje ligjore dhe kanë marr votat për tu rekomanduar sot në mbledhjen e KQZ-s.

**Alim Rama:** Desha një sqarim po ashtu nga këshilli për operacione zgjedhorë është se këtu e kemi shqyrtimi dhe miratimi projektit për aplikim, regjistrim të votuesve jashtë Kosovës në ueb-faqen e KQZ-s prej të cilit rrjedh dhe rrjedhimisht dokumenti shtesë i cili ka të bëjë me pyetje të shpeshta që ja lehtëson KQZ-s dhe e keni para jush në material.

**Arianit Elshani:** Kjo do të thotë është vetëm për ueb-faqe nuk është për sqarim.

**Valdete Daka:** Në kuadër të këshillit për çështje ligjore shtohet pika për procesverbal, pika verifikimi i aplikacioneve për regjistrim për periudhën e aplikimit të votuesve jashtë Kosovës. Si dhe pika ndryshimi dhe plotësimi i vendimit për miratimin e formularëve për aplikim për votim jashtë Kosovës. Këto janë çështje që janë shqyrtuar dhe futen si pika në kuadër të raportimit nga këshilli për çështje ligjore. Nëse nuk kemi diçka tjetër. Kush është për miratimin e këtij rendi të ditës me këto plotësime?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës.

## **2. Aktivitetet e ZRPPC-së**

**Shqyrtimi dhe aprovimi i kufizimit të shpenzimeve të fushatës për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës**

**Yll Buleshkaj:** Faleminderit kryetare, të nderuar anëtar. Ashtu edhe siç e dini edhe ju, zyra me shpalljen e ditës së zgjedhjeve dhe aprovimit të planit operacional ka filluar veprimtarin e saj duke e zgjatur orarin. Orari i rregullt i zyrës tashmë deri në certifikim të rezultateve është në dit të punës deri në ora 6:00, ndërsa vikendeve 8:00 deri në 4:00. Kjo e gjitha është bërë për arsye të zëmë në kohë afatet ligjore që i kanë subjektet politike dhe palët e tjera të interesuara për të aplikuar, çoftë ajo për certifikim edhe për regjistrim edhe për akreditim të vëzhguesve pastaj. Ajo çka është e rëndësishme pastaj është se ka përfunduar një afat për deklarim të partive politike për mos pjesëmarrje në zgjedhje si rezultat i kemi disa parti politike që nuk do të marrin pjesë që janë deklaruar e shumica nga këto janë relativisht parti të vogla asnjë nga këto nuk është parti parlamentare. Për këto do të pranoni një raport me shkrim se cilat janë ato, janë pesë parti duke përfshirë edhe nga komunitetet.

Një afat tjetër ligjor, është edhe caktimi i kufizimeve të shpenzimeve të fushatës i cili kufizim sipas ligjit për zgjedhje të përgjithshme duhet të merret si vendim brenda pesë ditëve nga shpallja e zgjedhjeve. Ne

kemi kontaktuar me shërbimin e listës votuese për ta marr numrin e votuesve sipas listës preliminare kanë ata, e numri total i votuesve për këto zgjedhje, listë preliminare është ekstrakti i parë është 1.869.662 votues. Ku i bie që çdo subjekt politik i cili do të certifikohet për të marr pjesë në zgjedhje mund të shpenzoj deri në 934.831 Euro. Ajo çka është e rëndësishme të ceket është që sipas këtij numri që kemi i përfshin edhe votuesit të cilët janë larguar me vendim të KQZ-s për shkak të vendimit për pajisje të dokumenteve të Unmikut është 2.804 më pak sesa numri i votuesve për zgjedhjet e njëjta që janë organizuar në vitin 2019. Pra i bie që edhe subjektet politike janë të lejuara ti shpenzojnë 1.402 euro më pak sesa para dy viteve. Keni para jush edhe draft vendimin i cili duhet të votohet dhe aprovohet nga ju.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë draft – vendim.

**Valdete Daka:** Faleminderit, pra sipas draft vendimit i bie që secila parti politike e cila merr pjesë në zgjedhje ka të drejt që në fushatë të shpenzoj shumë prej 934.831 Euro. Pra këto janë shpenzimet të cilat mund t'i kenë çdo parti. A kemi pyetje? Nëse jo. Kush është për miratimin e këtij rekomandimi?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim të shpenzimit.

**Yll Buleshkaj:** Ndoshta është shumë e rëndësishme që të gjitha partitë politike por edhe publiku ta dijë që afati i fundit për deklarim të koalicioneve është nesër në ora 6:00, par orës 6:00 do ta dimë a ka koalicione parazgjedhore.

**Valdete Daka:** Pra edhe njëherë e përsërisim, pesë (5) parti nuk do të marrin pjesë në zgjedhje sepse sot ka kaluar afati për deklarim të mospjesëmarrjes në zgjedhje ndërkaq deri nesër në ora 18:00 të gjitha partitë politike kanë të drejt të deklarojnë koalicionet eventuale këtu në KQZ. Vazhdojmë me pikën tjetër raporti i këshillit për operacione zgjedhore. Urdhëro Halim.

### **3.Raport i Këshillave të KQZ-së:**

#### **1.Këshilli për Operacione Zgjedhore**

Shqyrtimi dhe miratimi i tekstit për periudhën e aplikimit për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës në ueb faqen e KQZ-së:

**Halim Rama:** Faleminderit kryetare. Në këshill për operacione zgjedhore, kemi trajtuar përditësimin e informatave publikohen në ueb-faqen e KQZ-s në lidhje me aplikimin për votim jashtë Kosovës. Ky përditësim ka të bëjë me specifikimin më të hollësishëm të informatave dhe dokumentacionit me cilat dokumente aplikohet e keni para jush dokumentin, nuk kisha cek detaje por në dallim me ueb-faqen siç ka qenë deri tash këtu më shumë specifikohen se cilat janë dokumentet që qytetarët e Kosovës që jetojnë jashtë ta dinë konkretisht cilat janë dokumentet që i duhen. Kështu që në mënyrë unanime këshilli për operacione zgjedhore e ka aprovuar dhe e rekomandon KQZ-n për aprovim. Edhe dokumenti i ngjashëm është dokumenti për pyetje të shpeshta, pyetjet e shpeshta janë më orientuese dhe mendojmë që me këto informata shtesë qytetarët kanë për ta pasur më të qartë si të aplikojnë.

**Valdete Daka:** Pra edhe njëherë e përsërisim që të gjitha këto dokumente tashmë janë në ueb-faqen e KQZ-s dhe të gjithë e kanë të mundshme që nëpërmjet kësaj ueb-faqe ti gjejnë të gjitha këto dhe të fillojnë regjistrimin për votim me post. Nëse nuk kemi diçka tjetër lidhur me këto formularë.

**Halim Rama:** Vetëm një sqarim. Fillimi i aplikimit për post fillon me 13 janar, kështu që emaili është aktiv prej 13 janar nuk është ende.

**Sami Hamiti:** Për qartësim, duke u lexuar një vendim këtu nga KQZ-ja pat keqkuptime nëpër media pa e marr vendimin dolën disa afate të cilat saktësisht më mirë është këtë që e tha Halimi me saktësuar saktë datën të dy dokumenteve. Edhe në ueb-faqe sqarimet shitesë janë që mërgatës t’ju bëhet me e lehtë aplikimi, edhe te pyetjet e shpeshta një specifikim i të gjitha dokumenteve duke mundësuar lehtësim që të jenë sa më të kapshme për mërgatën. Prandaj edhe këtë që e tha Halimi, unanimisht e kemi votuar në KOZ.

**Valdete Daka:** Faleminderit, pra edhe njëherë e përsërisim ueb-faqja e KQZ-s është KQZ-KS.ORG, i lus mediat ta fokusojnë. Edhe njëherë se gjithmonë po na akuzojnë, nuk po kujdesemi për mërgatën. Pra kush është për miratimin e tekstit për periudhën e aplikimit për regjistrim kush është për?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim të KOZ-it.

## **2.Këshilli për Çështje Ligjore**

Shqyrtimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të kuvendit komunal në Podujevë:

**Arianit Elshani:** Faleminderit shumë kryetare. Këshilli për çështje ligjore ka trajtuar kërkesën për zëvendësimin e anëtarit të kuvendit komunal në Podujevë dhe me shumicë votash meqenëse ka kaluar të gjitha filtrat ligjore në kuadër të KQZ-s ka rekomanduar dhe rekomandon edhe sot në mbledhje të KQZ-s për miratim të zëvendësimit të anëtarit komunal.

**Valdete Daka:** Faleminderit shumë. Atëherë kush është që z. Ragip Fetahu të emërohet anëtar i kuvendit komunal në Podujevë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje duke zëvendësuar anëtarin e kuvendit komunal z. Vendenis Lahu. Kush është për?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë zëvendësim.

**Arianit Elshani:** Faleminderit shumë kryetare. Këshilli për çështje ligjore ka trajtuar kërkesën që ka ardhur nga këshilli për çështje zgjedhore, me që rast ka trajtuar kërkesën për verifikimin e aplikacioneve për regjistrim për periudhën e aplikimit për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës në këtë rast për diasporën dhe të gjithë ata që votojnë nga jashtë me qëllim që të forcohet dhe integriteti i institucionit ka ardhur edhe si rast tek ky vendim. Edhe nga këshilli për operacione zgjedhore edhe nga këshilli për çështje ligjore ka marr miratim. Faleminderit.

**Valdete Daka:** Faleminderit për të qenë më të qartë, unë do ta lexoj edhe njëherë por gjithsesi kjo do të del edhe nëpër media nga zëdhënësi ynë. Po e lexoj pasi i kemi këtu mediat. Pra:

*“Nga një email adresë aplikuesi mund të aplikoj për vete dhe për rrethin e ngushtë familjar që kanë të njëjtin mbiemër. Në formularët e aplikimit për regjistrim, aplikuesi duhet të shënoj vetëm numrin e tij të telefonit dhe, jo të ndonjë familjari. KQZ-ja do të verifikoj procesin e aplikimit për regjistrim duke i kontaktuar të gjithë aplikuesit përmes telefonit”.*

Kjo, është me rëndësi të ceket. Nëse aplikuesi nuk lajmërohet në telefon atëherë aplikacioni i tij do të refuzohet. Kush është për këtë vendim?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan kërkesën për verifikim të aplikacioneve në procesin e aplikimit për votim.

**Halim Rama:** Kjo ka të bëjë edhe me kërkesën që përsërite në rekomandimet e vëzhguesve të Bashkimit Evropian që me rrit integritetin e procesit të aplikimit me post.

**Valdete Daka:** Vazhdojmë me ndryshimin dhe plotësimin e vendimit.

#### Shqyrtimi dhe miratimi i ndryshimit dhe plotësimit të vendimit

**Arianit Elshani:** Faleminderit shumë. Edhe ky venim ka ardhur si rezultat nga këshilli për operacione zgjedhore për shkak të diskutimeve që janë zhvilluar dhe nga pyetjet që kanë qenë më të shpeshta lidhur me votimin nga jashtë. Është rekomanduar që të krijohet ky vendim meqenëse kemi miratuar javën e kaluar formularët për regjistrimin nga jashtë, andaj kemi një plotësim dhe këtë plotësim e rekomandon edhe këshilli për çështje ligjore që të aprovohet sot këtu. Faleminderit.

**Valdete Daka:** Që të mos kemi ndonjë keqkuptim formulari plotësohet me tekstin, shkruani numrin tuaj të telefonit në të cilin do ju kontaktojmë personalisht për verifikim jo pra të familjarit. Ky është pra i vetmi ndryshim. Kush është për këtë ndryshim?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan ndryshimin në vendim.

**Të ndryshme!**